



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2023:263209
Datë: 28.05.2024
Numri i dokumentit: 05742755

PPP.nr.161/23

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ - Departamenti i përgjithshëm, Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari Faton Ajvazi, në çështjen juridike përmbaremore të kreditorit J.A. nga Ferizaj, të cilin e përfaqëson av Vildane Hamiti nga Ferizaj, kundër debitorit Spitali i Përgjithshëm në Ferizaj, të cilën e përfaqëson B.R.Zh., për pagesën e pagës jubilarë dhe shpenzimet e procedurës, duke vendosur për prapësimin e ushtruar nga përfaqësuesi i debitorit, me datë 28.05.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET në tërësi si i pabazuar prapësimi i përfaqësuesit të debitorit Spitali i Përgjithshëm në Ferizaj, i ushtruar kundër urdhrin mbi lejimin e përmbaremit P.nr.355/2023, të datës 03.11.2023, i lëshuar nga Përmbareuesi Privat M.Sh. nga Ferizaj dhe **MBETET NË FUQI** urdhri mbi lejimin e përmbaremit P.nr.355/2023, i datës 03.11.2023.

A r s y e t i m

Me urdhrin për përmbaremit P.nr.355/2023, të datës 03.11.2023, Përmbareuesi privat M.Sh. e ka caktuar përmbaremin e propozuar nga i autorizuari i kreditorit J.A., kundër debitorit Spitali i Përgjithshëm në Ferizaj, për përmbaremin e aktgjykimit 2022:177385, të datës 04.09.2023, për pagesën e kompensimit të shpërblimit jubilar dhe shpenzimet e procedurës kontestimore, si dhe shpenzimet e procedurës së përmbaremit.

Kundër urdhrin për lejimin e përmbarimit, përfaqësuesi i debitorit, brenda afatit ligjor, ka ushtruar prapësim, me të cilin i ka propozuar gjykatës që ta aprovoj prapësimin si të bazuar dhe ta shfuqizoj urdhrin për përmbarim.

I autorizuari i kreditorit, në përgjigjen e ushtruar me shkrim, në prapësimin e debitorit, i ka propozuar gjykatës që ta refuzoj prapësimin e debitorit si të pabazuar dhe të mbetet në fuqi urdhri për përmbarim.

Gjykata i shqyrtoj shkresat e lëndës, urdhrin për përmbarim dhe pretendimet në prapësim të përfaqësuesit të debitorit dhe vlerësoj se prapësimi në fjalë është i pabazuar dhe nuk i plotëson asnjërin nga kushtet e parapara me nenin 71, par 1, të LPP-së.

Gjykata vlerëson se urdhri për përmbarim i lëshuar nga Përmbaruesi privat M.Sh., me numër P.nr.355/2023, i datës 03.11.2023, është i ligjshëm dhe i rregullt dhe se i njëjti nuk përmban shkelje të dispozitave të procedurës përmbarimore ngase përmbaruesi privat e ka lejuar përmbarimin në bazë të nenit 22, par 1, nën par 1.1, të Ligjit për Procedurën Përmbarimore.

Sa i përket pretendimeve të përfaqësuesit të debitorit në prapësim se: konsiderojmë se i mungon baza ligjore këtij propozimi nga fakti që konform Ligjit për Procedurën Përmbarimore nenin 5, par 6.2, kompetencë për zbatim të aktgjykimeve të kësaj natyre që lidhen me marrëdhënie të punës është Gjykata Themelore – zyra përmbarimore, gjykata këtë pretendim e konsideron të pabazuar sepse në bazë të Ligjit 08/L-102, për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Procedurën e Përmbarimit, përkatësisht nenit 3, paragrafi 2, të këtij ligji është ndryshuar neni 5 i ligjit bazik ku pas paragrafit 6, është shtuar edhe paragrafi 7, në të cilin është paraparë shprehimisht se : *“Përmbaruesi privat është kompetent për të vendosur në procedurën e përmbarimit dhe zbatimin e përmbarimit të vendimeve gjyqësore, lidhur me kompensimet nga marrëdhënia e punës”* dhe duke e marr parasysh këtë fakt gjykata konstaton se Përmbaruesi provat M.Sh., urdhrin për përmbarim të atakuar me prapësim e ka nxjerrë përveç në bazë të nenit 22, par 1, nën par 1.1, të LPP-së, edhe në bazë të Ligjit 08/L-102, për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Procedurën e Përmbarimit, përkatësisht nenit 3, në të cilin siç u cek më lart i është shtuar neni 5, edhe paragrafi 7.

Gjithashtu, gjykata konstaton se i autorizuari i kreditorit bashkë me propozimin për përbarim, tek përbaruesi privat e ka dorëzuar edhe aktgjykimin 2022:177385, të datës 04.09.2023, në origjinal të tij dhe me klauzolën e përbarueshmërisë për përbarueshmëri, gjegjësisht aktgjykimi është i plotfuqishëm nga data 13.10.2023 dhe i ekzekutueshëm nga data 23.10.2023, dhe kështu në këtë rast nga i autorizuari i kreditorit janë respektuar në tërësi dispozitat e nenit 36, par 1, të LPP-së.

Gjykata po ashtu në rastin konkret konstaton se i autorizuari i kreditorit, propozimin për përbarim e ka përpiluar në pajtim të plotë me nenin 38, par 1, të LPP-së, gjegjësisht në të është treguar dokumenti përbarimor në origjinal të tij, kreditori dhe debitori, si dhe adresa e vendbanimit të tyre, përkatësisht selia e debitorit, si dhe të dhënat tjera të cilat janë të nevojshme për zbatimin e përbarimit.

Përveç tjerash, gjykata konstaton se aktgjykimi i cekur më lart është në tërësi i përshtatshëm për përbarim dhe në pajtim me nenin 27, par 1, të LPP-së, pasi që në të është treguar kreditori dhe debitori si dhe objekti, mjetet, shuma e cila është prej 733.43 euro dhe shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej 98 euro dhe koha e përmbushjes së detyrimit, siç është afati prej 7 ditësh, pas marrjes së formës së prerë të aktgjykimit.

Andaj, Gjykata duke i marr parasysh thëniet e përfaqësuesit të debitorit në prapësim, përgjigjen me shkrim të autorizuarit të kreditorit në prapësimin e debitorit, provat dhe shkresat tjera të lëndës, konstatoj se prapësimi i debitorit është i pabazuar dhe vendosi që të njëjtin ta refuzoj në tërësi si të pabazuar ndërsa urdhri për përbarim P.nr.355/2023, i datës 03.11.2023, të mbetet në fuqi.

Nga të cekurat më lart dhe bazuar në nenin 73, par 1, 2 dhe 3, të LPP-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ

PPP.nr.161/23, më datë 28.05.2024

GJYQTARI

Faton Ajvazi

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktvendimi mund të ushtrohet ankesë Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate, në afatin prej 7 ditësh, nga dita e pranimit të aktvendimit.